

There are no translations available.



Më datë 11 Qershor 2012 Ministria e Ekonomisë dhe Tregtisë së Kosovës, Mimoza Kusari – Lila, nxori vendimin mbi tarifën tatimore 35% të çimentos.

Për këtë vendim që dëmtonte shumë punëtorët e fabrikave të çimentos menjëherë reagoi Bashkimi i Sindikatve të Pavarura të Shqipërisë , i cili në mbrojtje të interesave të mbi 1000 punëtorëve të tre fabrikave të çimentos kundërshtoi menjëherë këtë vendim duke iu drejtuar më datë 15.06.2012 Kryeministrit të Shqipërisë , z. Sali Berisha, Kryeministrit të Kosovës z. Hashim Thaçi , Ministres së Ekonomisë dhe Tregtisë së Kosovës Mimoza Kusari – Lila , si dhe Ambasadorit të Republikës së Kosovës, z. Sylejman Selimi .

Nëpërmjet kësaj korespondence BSPSH kërkonte ndjeshmërinë e organeve të qeverisë së Shqipërisë dhe Kosovës , gjithashtu, kërkesa e BSPSH-së i drejtohej organeve kompetente duke shfrytëzuar të gjitha hapsirat demokratike të dialogut social për zgjidhjen e kësaj tarife , si dhe të tarifave të tjera të vëna për prodhimet Shqiptare e Kosovare si prodhime të shqiptarëve.

Më datë 18.06.2012 President i BSPSH z. Gëzim Kalaja takoi në Ambasadën e Kosovës në Shqipëri z. Sylejman Selimi , Ambasador të Republikës së Kosovës në Tiranë dhe në bisedën midis tyre ata ndanë të njëjtin mendim që kjo taksë duhet të hiqet. Z. Ambasador i premtoi BSPSH-së se do të bënte të gjitha përpjekjet për anulimin e këtij vendimi .

Pas këtij takimi BSPSH mbledhi organin e saj drejtues dhe vendimor midis Kongreseve të Këshillit Kombëtar të BSPSH.

Në këtë mbledhje në mënyrë unanime u vendos që punëtorët e fabrikave të çimentos të mbështetur nga strukturat e BSPSH në Tiranë e disa rajone të protestonin para Ministrisë së

Ekonomisë , Tregtisë dhe Energjitikës, si dhe para Ambasadës së Republikës së Kosovës në Tiranë .

Para realizimit të këtij vendimi Presidenti i BSPSH ndërmorri një tjetër tratativë të dialogut social duke dashur evitimin e protestës së datës 09 Korrik 2012 , sidomos para Ambasadës së Kosovës , kështu më datë 5 Korrik 2012 iu dërgua një letër Kryeministrit të Shqipërisë z, Sali Berisha dhe Kabinetit të tij e Këshilltarëve të tij politikë, si dhe Shefit të kabinetit të Ministres Kusari – Lila, ku përsëri kërkonin me argument anulimin e vendimit nga zonja Kusari – Lila.

Më datë 09 Korrik 2012 , Presidenti i BSPSH shkoi në Prishtinë , ku dha një Konferencë për shtyp me pjesëmarrjen e mediave vizive dhe atyre të shkruara të Kosovës. Ai , së bashku me drejtues të BSPSH-së dhe Presidentin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës , z. Haxhi Arifi , morën pjesë në protestën e punëtorëve kosovarë në Prishtinë kundër vendimit të Ministres Mimoza Kusari – Lila .

Po në këtë datë z. Kalaja ka zhvilluar një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë së Kosovës nga ku u informuan për hollësi dhe argumente të këtij vendimi , si dhe rolin e Ministrisë Shqiptare të Ekonomisë.

Pas këtyre përpjekjeve duke përdoruar format më efektive të dialogut social BSPSH dhe lidërshipi i saj vendosi të zbatojë vendimin e Këshillit Kombëtar të BSPSH për protestën që do të zhvillohej më 20 Korrik 2012.

Më datë 20 Korrik 2012 në selinë e BSPSH filloi protesta e madhe e punëtorëve të fabrikave të çimentos dhe punëtorëve të ndërmarrjeve të ndryshme në Tiranë , si dhe sindikalistë nga rajonet e vendit.

Në protestë ishin mbi 2000 protestues të cilët pasi dëgjuan fjalën e mbajtur para tyre nga President i BSPSH z. Gëzim Kalaja u nisën në një marshim në kolonë të rregullt drejt rrugës së Kavajës , ku kaluan pak minuta para Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta , si për t'i bërë një mesazh Ministrisë si përgjegjëse për marrëdhëniet Sindikatë – Qeveri dhe më pas protestuesit u inkuadruan para Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës , atje President i BSPSH z. Gëzim Kalaja nëpërmjet megafonit i bëri thirrje Ministrit Haxhinasto t'i thotë Ndall! Indiferencës së shtetit shqiptar ndaj tarifës doganore prej 35% të çimentos , vendim ky i marrë më datë 11 Qershor 2012 nga Ministria Mimoza Kusari- Lila.

Protestuesit hidhnin parulla paqësore , ata i kërkonin qeverisë shqiptare të mbrojë punëtorët e fabrikave të çimentos që kërcënohen me vendin e punës prej kësaj takse jashtëzakonisht të madhe .

Parullat që mbanin në dorë protestuesit ishin :

- Rruga e Kombit e bashkoi Kosovën me Shqipërinë , Ministria Kusari – Lila po e ndan.
- Kryeministrave Thaçi dhe Berisha nëpërmjet pankartave ju bëhej thirrje të hiqnin taksat doganore për Shqipërinë dhe Kosovën nën motivin që janë prodhime shqiptare .

Mbas 30 minuta qëndrim , protesuesit vazhduan rrugën e tyre në Bulevardin Dëshmorët e

Kombit, pa akses, në qetësi, me rregull, ata u formatuan përsëri para Ambasadës së Republikës së Kosovës, ku edhe atje President i BSPSH z. Gëzim Kalaja përsëri foli për dëmet e taksës doganore prej 35% të çimentos, i'u drejtua Ambasadorit dhe punonjësve të Ambasadës duke i'u bërë të qartë atyre se BSPSH e çmon shumë marrëdhënien e Kosovës me Shqipërinë si dy shtete të një kombi, se BSPSH nuk ka asgjë më Ambasadën e Kosovës dhe se protesta e tyre është ndaj vendimit të Ministres Mimoza Kusari – Lila.

Ai u ndal gjatë edhe në ngulmimin që BSPSH i bëri problemit të taksës doganore të patates dhe grurit të Kosovës, duke kërkuar me insistim, ashtu si kundër para Ministris së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës heqjen e taksës doganore për Kosovën.

Pas 30 minuta protestë para Ambasadës së Republikës së Kosovës, protestuesit u shpërndan në mënyrë të rregullt në drejtimet nga kishin ardhur.

Më datë 26.07.2012 u rimblodh Këshilli Kombëtar i BSPSH për të bërë analizën dhe konkluzionet mbi protestën, i cili vendosi që në rast se Ministria Kusari – Lila nuk respekton vendimin për anulimin e vendimit të datës 11 Qershor 2012, BSPSH dhe BSPK do të organizojnë sëbashku me punëtorët e fabrikave të çimentos bllokimin e tunelit të Kalimashit në rrugën e Kombit.

Pritet nga Ministria e Ekonomisë të hiqet nga data 1 Gusht ky vendim dhe këtë e konfirmoi edhe Ministri i jashtëm z. Enver Hoxhaj pas takimit me Ministrin e Jashtëm të Shqipërisë z. Edmond Panariti.

Në këtë ndërmarrje të madhe sindikaliste, BSPSH vlerëson shumë kontributin e mediave shqiptare dhe kosovare, të cilat ndihmuan në evidentimin e kësaj veprimtarie me mjetet e tyre informative, gjithashtu, BSPSH dhe lidhshipi i saj z. Gëzim Kalaja falenderuan shumë Sekretarin e Përgjithshëm të IndustriAll Global Union z. Jyrika Raina për solidaritetin që i dha protestës tonë në emër të 50 milion punëtorëve, anëtarë të kësaj sindikate.

Gjithashtu edhe z. Haxhi Arifi, Kryetar i BSP Kosovës për solidaritetin sindikalist të shprehur me pjesëmarrjen e tij në veprimet tona sindikaliste.

Një falenderim të madhë, President i BSPSH, i drejton punëtorëve shqiptar, anëtarë të BSPSH për pjesëmarrjen e tyre në protestën e madhe të organizuar nga BSPSH.